

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura III

Seancë konstitutive e Kuvendit të Kosovës

P- 001

Prishtinë, më 04 dhe 09 janar 2008

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën konstitutive e kryesoi deputeti më i vjetër në moshuar, akademik Mark Krasniqi, kurse i ndihmoi deputetja më e re Njoza Emini.

Kryesuesi hapi seancën dhe i përshëndeti deputetët e Legjislaturës së tretë, PSSP, z. Joachim Ruecker, përfaqësuesit e zyrave diplomatike në Prishtinë, komandantin e KFOR-it, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e mediave, si dhe të pranishmit e tjerë.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se pika e tretë e rendit të ditës shtyhet për 9 janar 2008. Ai konstatoi se në seancë janë të pranishëm 117 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Seanca i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Formimi i Komisionit për Mandate dhe Imunitete,
2. Betimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

1. Formimi i Komisionit për Mandate dhe Imunitete

Kryesuesi i ftoi partitë parlamentare, që në bazë të Rregullës 3.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, ta propozojnë nga një deputet në Komisionin për Mandate dhe Imunitete, i cili do të shikojë dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve të mbajtura më 17 nëntor 2007.

Partitë parlamentare i propozuan anëtarët e Komisionin për Mandate dhe Imunitete si vijon:

Fatmir Lima, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, propozoi deputetin Arsim Bajrami.

Nekibe Kelmendi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoi deputetin Lutfi Haziri.

Ibrahim Makolli, në emër të Aleancës Kosova e Re, propozoi deputeten Suzana Novobërdaliu.

Lulzim Zeneli, në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, propozoi deputeten Besa Gaxheri.

Ardian Gjini, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, propozoi deputetin Ibrahim Selmanaj.

Mahir Yagcilar, në emër të Grupi 7+, (që përbëhet nga KDTP, Vakrat dhe PREBK), propozoi deputeten Shpresa Murati.

Sabit Rrahmani, në emër të Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, propozoi deputetin Hetem Arifi.

Në emër të Partia Demokratike Serbe dhe Partisë Popullore u propozua deputeti Vladimir Todoroviq.

Slobodan Petrviq, në emër të Demokracisë së re, të Lidhjes së Socialdemokratëve të Pavarur dhe të Iniciativës Qytetare të Goranëve propozoi deputetin Lubisha Zhiviq.

Numan Baliq, në emër të SDA-së, propozoi deputeten Vezira Emrush.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e cekura më lart. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----117;

Kundër-----0;

Abstenime---0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri zgjodhi Komisionin për Mandate dhe Imunitete.

Komisioni për Mandate dhe Imunitete kaloi në sallën N-10, që ta shikojë dokumentacionin përkatës zgjedhor për deputetët e Kuvendit.

Kryesuesi, në vazhdim e ftoi PSSP z. Ruecker që t'u drejtohej deputetëve me një fjalë rasti.

Z. Joachim Ruecker uroi deputetët e Kuvendit për zgjedhjet e Legjislaturës së tretë, duke u dëshiruar punë të suksesshme gjatë këtij mandati.

Ai e falënderoi punën e deputetëve të legjislaturës së mëparshme dhe punën e Presidentit e të Qeverisë së Kosovës.

Pastaj, në emër të Komisionit për Mandate dhe Imunitete, deputeti **Arsim Bajramin**, Kuvendit ia paraqiti Raportin: Në mbështetje të rregullës 3.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 4 janar 2008, shikoi dokumentacionin përkatës zgjedhor, si vijon:

- Rekomandimin e Komisionit Qendror Zgjedhor për certifikimin e rezultateve zgjedhore për Kuvendin e Kosovës;
- Vërtetimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 17 nëntor 2007;
- Listën e deputetëve të regjistruar në Kuvendin e Kosovës.

Komisioni, në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të cekur më lart,

K O N S T A T O I:

1. Në Legjislaturën e tretë të Kuvendit të Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 17 nëntorit të vitit 2007, si vijon:

- Partia Demokratike e Kosovës, 37 deputetë;
- Lidhja Demokratike e Kosovës 25 deputetë;
- Aleanca Kosova e Re 13 deputetë;
- Koalicioni Lidhja Demokratike e Dardanisë – Partia Shqiptare Demokristiane 11 deputetë;
- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 10 deputetë;
- Subjekti SDSKiM 3 deputetë;
- Subjekti SLS 3 deputetë;
- Koalicioni VAKAT 3 deputetë;
- Subjekti KDTP 3 deputetë;
- Subjekti PDAK 3 deputetë;
- Subjekti SDA 2 deputetë;
- Subjekti PREBK 1 deputet;
- Subjekti SNSDKIM 1 deputet;
- Subjekti IRDK 1 deputet;
- Subjekti SNS 1 deputet;
- Subjekti politik SKMS 1 deputet dhe
- Subjekti politik GIG 1 deputet.

Komisioni konstatoi se në seancën e sotme janë të pranishëm 112 deputetë, andaj i propozohet seancës plenare të bëjë verifikimin e mandateve dhe të vazhdojë punimet sipas agjendës së paraparë dhe rregullave të procedurës.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin e Komisioni. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----112;

Kundër-----0;

Abstenime---0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi raportin e Komisionit për Mandate dhe Imunitete.

2. Betimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Kryesuesi në bazë të Rregullës 3.3 të rregullores së Punës të Kuvendit, kërkoi nga deputetët që ta japin betimin solemn. Deputetët u ngrihen në këmbë, kurs kryesuesi lexoi tekstin e betimit, si vijon: *“Unë, deputet i Kuvendit të Kosovës, i zgjedhur me votën e lirë, sot solemnisht betohem se me ndershmëri e sinqeritet, me përkushtim dhe devotshmëri, me tërë qenien time, me të gjitha aftësitë e mia do të punoj në interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve, do të angazhohem në mbrojtjen dhe respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, në mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, në garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në pajtim me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”*. Në fund, deputetët shqiptuan fjalën **B e t o h e m i!**

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 14:45 minuta.

E martë, më 9 janar 2008

Vazhdimi i seancës konstitutive të Kuvendit të Kosovës

Seanca filloi punën në orën 12:00.

Seancën konstituive e kryesoi deputeti më vjetër, në moshë, akademik Mark Krasniqi, kurse i ndihmoi deputetja më e re Njoza Emini.

Kryesuesi hapi seancën dhe konstatoi se në sallë janë 117 deputetë.

Seanca i vazhdoi punimet me këtë

R e n d d i t e:

2. Zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës,
3. Zdhjedhja e Kryetarit të Kosovës dhe
4. Zgjedhja e Qeverisë së Kosovës.

2. Zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës

Kryesuesi i informoi deputetët për procedurat e propozimit të anëtarëve të Kryesisë dhe të Kryetarit të Kuvendit.

PDK – dy anëtarë, meqë ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet parlamentare, duke deklaruar se njëri prej tyre do të emërohet Kryetar i Kuvendit;

LDK – dy anëtarë, si parti e dytë me numrin e fituar të votave;

AKR – një anëtar, si parti e tretë me numrin e fituar të votave;

LDD–PSHDK një anëtar si parti e katërt me numrin e fituar të votave;

Një anëtar nga radhët e deputetëve të partive që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb;

Një anëtar nga radhët e komunitetit joshqiptar dhe joserb në Kosovë, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre.

Kryesuesi kërkoi nga kryetarët e partive politike t'i propozonin emrat e kandidatëve për anëtarë të Kryesisë.

Deputeti Ramë Buja, kryetar i Grupit Parlamentare të PDK-ës për anëtar të Kryesisë e propozoi Xhavit Halitin, kurse për kryetar të Kuvendit Jakup Krasniqi. Në vazhdim ai e dha një biografi të shkurtër lidhur me jetën dhe veprimtarin e z. Krasniqi.

Deputetja Nekibe Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës për anëtarë të Kryesisë propozoi Sabri Hamitin dhe Eqrem Kryeziun.

Deputeti Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së për anëtar të Kryesisë e propozoi Ibrahim Gashin.

Deputeti Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-ës dhe PSHDK-së për anëtar të Kryesisë propozoi Nexhat Daci.

Deputeti Sllavisa Petkovic tha se kandidatin për anëtar të Kryesisë do ta paraqesin në seancën e ardhshme, pasi që akoma nuk kanë arritur një marrëveshje të gjithë deputetët që e përfaqësojnë komunitetin serb në Kosovë.

Deputeti Mahir Yagcilar, në emër të Grupit parlamentar + (VAKAT, KDTP, PREBEK) për anëtarë të Kryesisë propozoi Xhezair Muratin.

Deputeti Sabit Rrahmani, në emër të PDAK, kërkoi që përfaqësuesi i këtij subjekti të jetë anëtar i kryesisë së Kuvendit.

Deputeti Numan Balic, tha se në bazë të Kornizës Kushtetuese, anëtari i Kryesisë nga radha e komuniteteve joshqiptare dhe jo serbe zgjedhet në bazë të konsultimeve dhe të marrëveshjes ndërmjet tyre. Me këtë rast nuk është konsultuar askush me SDA-në dhe me Ashkalinjtë.

Në mandatet e mëparshme anëtarë të Kryesisë kanë qenë nga radhët e KDTP-së, të VAKAT-it dhe të egjiptasëve. Kësaj radhe anëtari i Kryesisë nga radha e komuniteteve joshqiptare dhe joserbe duhet të zgjedhet nga SDA-ja.

Kryesuesi tha se duke marrë parasysh se deputetët e partive parlamentare që e përfaqësojnë komunitetin serb dhe ata që e përfaqësojnë komunitetin joshqiptar dhe joserb ende nuk kanë arritur marrëveshje për t'i propozuar anëtarët e Kryesisë nga radha e tyre, atëherë emërimi i tyre shtyhet për seancën e ardhshme.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----88;

Kundër-----1;

Abstenime---0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryesisë dhe të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës

I. Jakup KRASNIQI zgjedhet Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

II. Anëtarë të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës zgjedhen:

1. Xhavit Haliti, nga PDK-ja;
2. Sabri Hamiti, nga LDK-ja;
3. Eqrem Kryeziu, nga LDK-ja,
4. Ibrahim Gashi, nga AKR-ja;
5. Nexhat Daci, nga LDD-ja.

III. Anëtari i Kryesisë që përfaqëson komunitetin serb në Kosovë dhe ai që përfaqëson komunitetet joshqiptare dhe joserbe do të emërohen në njërën nga seancat e ardhshme të Kuvendit, sipas mënyrës së paraparë në kreun 9.1.7(e) dhe (f) të Kornizës Kushtetuese.

IV. Mandati i Kryetarit të Kuvendit dhe i anëtarëve të Kryesisë zgjat katër (4) vjet.

Kryesuesi e ftoi kryetarin e sapo zgjedhur që ta kryesojë seancën.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari i falënderoi deputetët e Kuvendit për besimin e dhënë. Ai i ftoi deputetët e të gjithë grupeve parlamentare për një bashkëpunim të sinqertë, profesional, demokratik dhe tolerantë për ta kryer me sukses misioni ky legjislacon.

Në vazhdim, kryetari i falënderoi edhe institucionet e pranisë ndërkombëtare për kontributin e dhënë për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova.

Kryetari, e ftoi ta marrë fjalën PSSP Z. Joachim Ruecker dhe pasta të vazhdohet me propozime.

Joachim Ruecker ia uroi zgjedhjen kësaj legjislature veçanërisht kryetarin e Kuvendit z. Jakup Krasniqin duke u dëshiruar punë të frytshme gjatë këtij mandati.

Ai, gjithashtu, falënderoi edhe kryetarin e mëparshëm të Kuvendit, z. Kolë Berishen dhe deputetët e Kuvendit për sukseset gjatë mandatit të tyre.

Ai i falënderoi edhe Këshillin Qendror Zgjedhor, OSBE-në dhe partitë politike për korrektësinë e tyre gjatë fushatës dhe kontributin e tyre gjatë zgjedhjeve të fundit.

Ai paraqiti para deputeteve të Kuvendit një rezyme të shkurtër lidhur me veprimet pozitive të bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht UNMIK-ut dhe NATO-s me qëllim të zgjidhjes së çështjes së statusi të Kosovës, duke theksuar Pakon e Ahtisarit, përfundimin

e negociatave të Treshes, si dhe gatishmërinë e Unionit Evropian për të vendosur misionin e tij në Kosovë.

3. Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se kryetari aktual i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka paraqitur kërkesën për dorëheqjen e tij, e cila i është pranuar.

A i ftoi përfaqësuesit e partive parlamentare, që kanë të drejtë ta propozojnë kandidatin për kryetar të Kosovës.

Deputeti Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së për kryetar të Kosovës propozoi Fatmir Sejdiun. Ai paraqiti biografinë e kandidatit për Kryetar të Kosovës.

Deputeti Ahmet Isufi, në emër të 25 deputetëve paraqiti kandidatin për kryetar të Kosovës, Naim Malokun. Në vazhdim, ai paraqiti biografinë e kandidatit për kryetar të Kosovës.

Kryetari i njoftoi deputetët për të gjithë përgatitjet që kishte bërë Administrata e Kuvendit, si ato teknike dhe administrative, si dhe formimin e Komisionit të votimit, në përbërje: Sali Rexhepi, kryetar, Xheladin Hoxha dhe Natasha Prica anëtarë, të cilët nën mbikëqyrjen e deputetëve nga secili grup parlamentar, do t'i zbatojnë procedurat e votimit dhe të numërimit të votave.

Pastaj, **kryetari** i ftoi, një nga një, deputetët e Kuvendit për të votuar (me votim të fshehtë) për kryetar të Kosovës.

Pas përfundimit të raundit të parë të votimit dhe të numërimit të votave nga ana e Komisionit të votimit, **kryetari** e deklaroi rezultatin e votimit.

Në votim kanë marrë pjesë 115 deputetë.

Për Fatmir Sejdiun kanë votuar 62 deputetë;
Për Naim Malokun kanë votuar 37 deputetë dhe
Të pavlefshme ka qenë 16 fletëvotimi.

Kryetari tha se sipas këtij rezultati, në bazë Kreut 9.2.8 të Kornizës Kushtetuese dhe të rregullës 14.4 të Rregullores së Punës të Kuvendit, procedura e votimit duhet të përsëritet.

Kryetari i ftoi deputetët, një nga një, që të votojnë për kryetar të Kosovës.

Pas votimit dhe numërimit të votave nga Komisioni i votimit, **kryetari** e deklaroi rezultatin e rrethit të dytë të votimit.

Në votim kanë marrë pjesë 115 deputetë.

Për Fatmir Sejdiun kanë votuar 61 deputetë;
Për Naim Malokun kanë votuar 37 deputetë dhe
Të pavlefshme ka qenë 17 fletëvotime.

Kryetari tha se në bazë të Kreut 9.2.8 të Kornizës Kushtetuese dhe të rregullës 14.5 të Rregullores së Punës të Kuvendit, procedura e votimit për kryetar të Kosovës duhet të përsëritet.

Ai i ftoi deputetët e Kuvendit, një nga një, të votojnë për kryetar të Kosovës.

Pasa votimit në rrethin e tretë dhe të numërimit të votave nga ana e Komisionit të votimit, Kryetari e deklaroi rezultatin e votimit.

Në votim kanë marrë pjesë 118 deputetë.

Për Fatmir Sejdiun kanë votuar 68 deputetë;
Për Naim Malokun kanë votuar 39 deputetë dhe
Të pavlefshme ka qenë 11 fletëvotimi.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës

1. Kryetar i Kosovës zgjedhet dr. Fatmir Sejdiu.
2. Mandati i Kryetarit të Kosovës zgjat pesë (5) vjet.

Kryetari e ftoi Kryetarin e Kosovës t'u drejtohej deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Kosovës, Famir Sejdiu iu falënderua deputetëve të Kuvendit për besimin e dhënë dhe u zotua se do të vihet, me të gjitha fuqitë dhe dijen e tij, në mbrojtjen dhe respektimin e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë. Ai tha se kujdes të veçantë do t'i kushtojë ruajtjes së unitetit demokratik të vendit dhe me të gjitha energjitë do të angazhohet për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ai falënderoi patitë politike dhe qytetarët për kontributin dhe maturinë e tyre, që treguan gjatë zgjedhjeve të fundit.

Në vazhdim, Kryetari i Kosovës tha se institucionet e Kosovës, Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria do të përmbyllin me sukses procesin e pavarësimit të Kosovës në realizimin e vullnetit legjitim të popullit të saj dhe do ta miratojnë Kushtetutën e shtetit të ardhshëm të Kosovës. Do ta zgjerojnë korpusin legjislativ në përputhje me pakon e Presidentit Ahtisari dhe me standardet më të larta bashkëkohëse ndërkombëtare, si dhe gjithë korpusin legjislativ të nevojshëm për ta mbështetur funksionimin e institucioneve demokratike të saj dhe të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve. Do t'i ndërmarrim të gjitha veprimet e nevojshme që të përshpejtojmë integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike si orientim themelor i shtetit të Kosovës.

3. Zgjedhja e Qeverisë së Kosovës

Kryetari ftoi Kryetarin e Kosovës që në bazë të mandatit të tij ta propozojë kandidatin për kryeministër të Kosovës.

Kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu tha se në bazë Kreut 9.2.4 (b) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të Marrëveshjes së Koalicionit në mes të

Partisë Demokratike të Kosovës dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës për kryeministër të Kosovës e nominoi z. Hashim Thaçi, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe nga kandidati i nominuar kërkoi që para Kuvendit ta paraqesë përbërjen e Qeverisë së re.

Kryetari ftoi kandidatin e nominuar për kryeministër të Kosovës që ta paraqesë përbërjen e qeverisë së Kosovës.

Kandidati i nominuar për kryeministër të Qeverisë së Kosovës, **Zotin Thaçi**, në fjalimin e tij paraqiti një ekspozë për Programin e Qeverisë së re.

Ai i falënderoi të gjithë qytetarët e Kosovës për mbështetjen e dhënë, si dhe Kryetarin e Kosovës për dhënien e mandatit për formimin e Qeverisë.

Politika qeverisëse e Kosovës çdoherë do të mbetet e rrënjësuar në të drejtën e qytetarëve tanë. Qytetarët tanë me të drejtë janë duke prituri dhe janë duke vëzhguar me kujdes punën tonë. Ata kanë kërkuar dhe janë përcaktuar për ndryshime

Në emër të Qeverisë së Kosovës, do ta prezantoj para qytetarëve projektin gjithëpërfshirës për reformat ekonomike. Ky plan do të fillojë të ngjallë ekonominë kosovare me qëllim që ta shpie vendin tonë në epokën e re të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mundësive të reja.

Qeveria e re e Kosovës do të bëjë një rishikim të tërësishëm të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

Veprimi tjetër, që duhet ta bëjmë së bashku, është sigurimi i kredive me kamata të ulëta dhe afatgjate.

Zotohemi për krijimin e zonave industriale, të cilat do ta stimulojnë rritjen ekonomike.

Përmes lehtësirave të ndryshme tatimore, të dizajnuara për të tërhequr biznese të reja në Kosovë, bizneseve ekzistuese do t'iu krijojmë mundësi të zgjerimit dhe të krijimit të më shumë vendeve të punës.

Qeveria do të përgatit një pako të reformave të gjithanshme për t'i tejkaluar problemet ekzistuese, për të garantuar furnizim të rregullt dhe normal me energji.

Do të vazhdojmë përpjekjen për ta bërë Kosovën vendin më të gjelbër në Evropën Lindore. Ju ftoj që Kosovën ta bëjmë një qendër rajonale, të pastër për kërkimin në lëmin e energjisë, për zhvillimin, prodhimin dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Krijimi i rrjetit efikas infrastrukturor ndërkufitar do të jetë gjithashtu prioritet i Qeverisë së Kosovës, duke filluar nga rrugët, auto-rrugët e deri tek hekurudhat.

Kemi premtuar dhe zotohemi edhe sot se do të fillojmë ndërtimin e auto-rrugëve Prishtinë-Hani i Elezit, Vërmicë-Merdare, Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë, deri në kufi.

Do të fillojmë të implementojmë prioritetet tona në fushën e arsimit me qëllim që të ballafaqohemi me sukses me kërkesat e shekullit XXI. Do ta depolitizojmë arsimin.

Do ta fillojmë këtë projekt të madh, duke krijuar Fondin Nacional për Arsim, duke i ngritur pagat e mësimitdhënësve, duke i motivuar ata me shpërblime për arritjet në punë.

Do të fillojmë me vendosjen e qendrave kompjuterike në shkollat tona, me qëllim që kjo jo vetëm t'i lidhë shkollat ndërmjet veti, por edhe me shtetet tjera të botës.

Fokusimi në ekonomi, në energji, në infrastrukturë dhe në arsimim do të na mundësojë që të rrisim edhe buxhetin tonë të kufizuar. Kjo rritje na lejon pastaj që të koncentrohemi në programet sociale, për të cilat vendi ka aq shumë nevojë.
Zotohemi sot se Qeveria jonë do t'u kushtojë kujdes të madh të moshuarve dhe do ta reformojë fondin pensional.

Unë zotohem se do t'i jap fund ciklit të vazhdueshëm të humbjeve, të mashtrimeve dhe të abuzimeve me para të qytetarëve tanë.

Lufta kundër korrupsionit do të jetë e ashpër dhe me zero tolerancë ndaj kujtdo dhe kurdoherë që paraqitet.
Kosova do të funksionojë si një shtet i plotë në tërë territorin e saj.

Kërkoj unitetin tuaj të vazhdueshëm, besimin dhe mirëkuptimin. Unë zotohem se, të bashkuar, mund t'i arrijmë objektivat tona për të mirën e vendit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Në fund të ekspozesë, kandidati për kryeministër paraqiti, para deputetëve të Kuvendit Listën e kabinetit të Qeverisë së Kosovës.

Kryetari hapi debatin lidhur me propozimin e Kabinetit qeveritar,

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me propozimet e mandatarit për kryeministër të Qeverisë së Kosovës dhanë këta deputetë: **Gani Geci, Ahmet Isufi, Behxhet Pacolli, Gjylnaze Syla, Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Ali Lajqi, Mimoza Ahmetaj, Riza Smaka, Numan Balić, Besa Gaxherri, Slobodan Petrović, Xhevdet Neziraj dhe Driton Tali**, të cilat janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kandidatit për formimin e Qeverisë së Kosovë.
Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----85;
Kundër-----22 dhe
Abstenime---4.

Kryeministri Thaçi, paraqiti para deputeteve listën e zëvendësministrave të propozuar.
Kryetari, hodhi në votim propozimet e kryeministri Thaçi për, zëvendëskryeministra, ministra dhe për zëvendësministra. Rezultati ishte me sa vijon:

Për-----85;
Kundër-----22 dhe
Abstenime---4.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryeministrit, të zëvendëskryeministrave, të ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Kosovës

I. Kryeministër i Qeverisë së Kosovës zgjedhet z. **Hashim THAÇI**.

II. Zëvendëskryeministra: z. Hajredin Kuçi dhe z. Ramë Manaj.

III. Ministra në Qeverinë e Kosovës zgjedhen:

1. Fatmir Limaj, ministër i Transportit dhe i Postë-Telekomunikacionit, Adem Grabovci, zëvendësministër i Transportit dhe i Postë-Telekomunikacionit;
2. Ahmet Shala, ministër i Ekonomisë dhe i Financave, Bedri Hamëza, zëvendësministër i Ekonomisë dhe i Financave;
3. Arsim Bajrami, ministër i Shërbimeve Publike, Rifat Blaku, zëvendësministër i Shërbimeve Publike;
4. Enver Hoxhaj, ministër i Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Agim Hyseni, zëvendësministër i Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë;
5. Justina Pula-Shiroka, ministre e Energjetikës dhe e Minierave, Blerim Rexha, zëvendësministër i Energjetikës dhe i Minierave;
6. Nekibe Kelmendi, ministre e Drejtësisë, Arsim Janova, zëvendësministër i Drejtësisë;
7. Lutfi Zharku, ministër i Tregtisë dhe i Industrisë, Naser Osmani, zëvendësministër i Tregtisë dhe i Industrisë;
8. Alush Gashi, ministër i Shëndetësisë, Mubera Mustafa, zëvendësministre e Shëndetësisë;
9. Zenun Pajaziti, ministër i Punëve të Brendshme, Fatmir Xhelili, zëvendësministër i Punëve të Brendshme;
10. Idriz Vehapi, ministër i Bujqësisë, Sylë Syllanaj, zëvendësministër i Bujqësisë;
11. Sadri Ferati, ministër i Pushtetit Lokal, Shpend Terdeva, zëvendësministër i Pushtetit Lokal;
12. Skender Hyseni, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Lirije Kajtazi, zëvendësministre e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
13. Mahir Yagcilar, ministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, Emin Krasniqi, zëvendësministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor;
14. Nenad Rashiq, ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Gjergj Dedaj, zëvendësministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale dhe
15. Boban Stanković, ministër i Kthimit dhe i Komuniteteve.

Zëvendësministri i Kthimit dhe i Komuniteteve do të zgjedhet pas konsultimeve me partnerët e Koalicionit, në seancën e ardhshme të Kuvendit.

IV. Mandati i Qeverisë së Kosovës zgjatë katër (4) vjet.

4. Betimi i Qeverisë

Kryetari kërkoi nga Kabineti Qeveritar që ta japin betimin.

Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Hashim Thaçi e lexoi tekstin e betimit, si vijon: *“Ne, anëtarët e Qeverisë së Kosovës, të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, betohemi solemnisht se me përgjegjësi, me përkushtim dhe me ndershmëri do t’i kryejmë të gjitha detyrat dhe punët që i kemi sipas mandatit të dhënë nga ky Kuvend, gjithmonë duke zbatuar ligjin dhe vendimet e miratuara, duke respektuar parimet, normat dhe standardet ndërkombëtare për liri, barazi, demokraci, në interes të përparimit ekonomik, arsimor, kulturor e të gjithmbarshëm të popullit dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës”*. Në fund, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe zëvendësministrat shqiptuan fjalën **b e t o h e m i!**

Kryetari ia dha fjalën kryeministrit Thaçi.

Kryeministri **Hashim Thaçi** i falënderoi deputetët e Kuvendit dhe qytetarët e Kosovës për besimin e dhënë dhe u zotua se do të punojë me të gjithë për të mirën e qytetarëve të vendit.

Pastaj, deputetëve të Kuvendit iu drejtua edhe z. **Joachim Ruecker**, PSSP, i cili përshëndeti formimin e Qeverisë së Kosovës dhe zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës, duke theksuar se do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e zgjedhura për vazhdimin e proceseve në Kosovë.

Në fund, Kryetari i Kosovës, **Fatmir Sejdiu**, uroi Kryeministrin e ri dhe Qeverinë e re por edhe opozitën për bashkëpunimin, duke premtuar se do të jetë zë unifikues dhe bashkëpunues me institucionet e Kosovës.

Ai falënderoi edhe përfaqësuesit e Bashkësisë Ndërkombëtare, SHBA-të, Bashkimin Evropian dhe NATO për mbështetjen që i kanë dhënë Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 19:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

Përgatiti

Njësia për Çështje Plenare dhe Procedurale